



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN
OSNOVNI SUD PRIZREN – BASIC COURT OF PRIZREN

Në mbështetje të Ligjit Nr.06/L-055 për Gjykatat dhe Rregullores Nr.02/2019 për Rekrutimin, Emërimin, Trajnimin, Shpërblimin, Disiplinimin dhe Lirimin nga detyra të Gjyqtarëve Porotë, Gjykata Themelore në Prizren shpall:

KONKURS
Nr.01/2022

Titulli i vendit të punës: Gjyqtarë Porotëdymbëdhjetë (12) pozita,

Gjyqtar Mbikëqyrës: Kryetari i Gjykatës/Gjyqtarë Mbikëqyrës

Kohëzgjatja e emërimit: Emërimi për një mandat pesë vjeçar (5), me të drejtë riemërimi.

1. **Gjykata Themelore në Prizren dhjetë (10) pozita**
2. **Gjykata Themelore në Prizren - Dega në Suharekëdy (2) pozita**

Detyrat dhe përgjegjësitë e Gjyqtarëve Porotë

1. Gjyqtarët Porotë ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në Legjislacionin në fuqi, në pajtim me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Gjyqtarëve Porotë ndër të tjera përfshinë këto pika sinë vijim:
 - a) Kryen detyrat që i besohen gjatë shqyrtimit të rastit,
 - b) Kryen me ndërgjegjshmëri dhe paanshmëri të gjitha detyrat që i besohen,
 - c) Trajton me konfidencialitet të gjitha informatat të cilat nuk duhet të jenë publike ose të cilat janë diskutuar gjatë seancës për këshillim dhe votim dhe
 - d) Kryen detyra të tjera të përcaktuara nga Kryetari i Gjykatës përkatëse.

Kualifikimet:

- Diploma e shkollës së mesme,
- Diplomë Universitare e preferuar.

Aftësitë e kërkuara

- Dëshmi mbi shtetësinë e Kosovës (certifikatë e shtetësisë)
- Dëshmi se kandidati është banor i Republikës së Kosovës (certifikata e vendbanimit)
- Dëshmi që kandidati ka moshën të paktën 25 vjeçare dhe
- Certifikatën që vërteton se kandidati nuk është i dënuar për vepra penale me përjashtim të veprave penale të kryera nga pakujdesia.

VËREJTJE:

Procedura e Rekrutimit zhvillohet sipas procedurave të parapara me Ligjin për Gjykatat Nr.06/L-055 dhe Rregullores Nr.02/2019 për Rekrutimin, Emërimin, Trajnimin, Shpërblimin, Disiplinimin dhe Lirimin nga detyra të Gjyqtarëve Porotë.

Konkursi publikohet me datë **01.11.2022** dhe mbyllet me datë **15.11.2022**.

Shkarko Aplikacionin

Aplikacionet mund t'i merrni në Gjykatën Themelore në Prizren, rr."Willaim Walker" pn. dhe aplikacionet mund t'i shkarkoni në mënyrë elektronike në Web Portalin e KGJK-së www.gjyqesori-rks.org, ndërsa dorëzimin e aplikacioneve mund ta bëni fizikisht në Gjykatën Themelore në Prizren apo përmes Postës në Kodin postar 20000.

Në Konkurs ofrohen mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpritën aplikacionet nga të gjitha gjinitë dhe komunitetet në Kosovë.

Gjykata siguron që numri i Gjyqtarëve Porotë pasqyron përbërjen etnike të zonës që hynë nën juridiksionin e saj.

Kandidatët të cilët nuk i dorëzojnë dokumentet e kërkuara në pajtim me këtë Rregullore brenda afatit dhe ata të cilët nuk i plotësojnë të gjitha kushtet ligjore në pajtim me Ligjin për Gjykatat, nuk merren në shqyrtim dhe njoftohen se aplikacionet e tyre nuk janë të suksesshme.

Njoftimi përmban arsyen se pse aplikacioni nuk ka qenë i suksesshëm.

Për çdo paqartësi mund të kontaktoni në tel.fiks 029/223-773